



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 635 Prot.

Tiranë, më datë 23.04.2021

VENDIM
Nr. 225, datë 23.04.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 23.04.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin raportit të sondazheve arkeologjike në kuadër të projektit "Impianti i trajtimit të mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës", Bashkia Vlorë, përgatitur nga individ i licencuar Znj. Iris Pojani. Relacion i verifikimit nga DSHA;
2. Miratimin e konceptit të gërmimit arkeologjik të shpëtimit për Qelizën 1, të projektit "Impianti i trajtimit të mbetjeve të ngurta të rajonit të Vlorës", përgatitur nga individ i licencuar Znj. Iris Pojani
3. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
4. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji Iris Pojani, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Qendra të reja banimi, komplekse rezidencial, resorte dhe fshatra turistike tradicionale", si dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
5. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", nenet 144-147;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
7. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

KRYETAR
Elva MARGARITI

